



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



## **EKSTRAKT I PROCESVERBALIT**

**të mbledhjes së parë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 09.02.2022,  
duke filluar në orën 10:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Fehmi Kupina, kryesues i Komitetit, anëtarët e Komitetit: Nora Kelmendi, Arbnora Berisha, Mirsad Vitia, Gëzim Sveçla, Jeta Rafuna, Donjeta Dragusha, Shegë Beqiri dhe Bahri Gashi.

**Në mbledhje ishin të pranishëm edhe:** Valbona Ahmeti - Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Osman Bllaca, Fatos Dibra, përfaqësues nga Zyra ligjore, Faton Dragusha, Lulzim Vrapca, Betim Abdullahu, Leutrim Retkoceri dhe përfaqësues të KFOR-it italian.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Fehmi Kupina, kryesues.**

Ai bëri të ditur se në këtë mbledhje nuk merr pjesë z. Donat Lushaku, pasi që është emëruar drejtor i Drejtorisë së Kadastrit, dhe për mbledhjen e radhës do të zëvendësohet.

Para se të fillonin me diskutimet për pikat e rendit të ditës, kryesuesi tha se është kërkesë e kryetarit që të futet në rend dite edhe pika **“Propozimvendimi për shfuqizimin e Vendimit, 01 - 422/01 - 0217897/20, të dt. 26.11.2020, për subvencionimin e qytetarëve të komunës së Prishtinës të infektuar me COVID-19”**.

Kryesuesi e hodhi në votim komplet rendin e ditës, me pikën shtesë.

### **REND DITE:**

- 1. Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 tetor - 31 dhjetor 2021 (TM4);**
- 2. Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2021;**
- 3. Propozimvendimi për miratimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022;**

4. Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;
5. Propozimvendimi për formimin e Komitetit për Komunitete;
6. Informatë për suksesin e nxënësve në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2021/2022;
7. Propozimvendimi për shfuqizimin e Vendimit, 01 - 422/01-0217897/20, të dt.26.11.2020, për subvencionimin e qytetarëve të komunës së Prishtinës të infektuar me COVID-19;
8. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se u miratua ky rend dite.

**Gëzim Sveçla** bëri vërejtje, duke thënë se kjo mbledhje po mbahet dy ditë para seancës së Kuvendit, e kjo nuk duhet të bëhet si praktikë, sepse nëse ne fusim tash pika të rendit të ditës dhe nëse është materiali voluminoz, si kemi me shqyrtuar ne për seancën që është mbas dy ditësh.

Si Grup i VV-së, propozojmë që të futet si pikë e rendit të ditës për seancën e Kuvendit, të dt. 11 shkurt, "Diskutim mbi gjendjen në ndërmarrjen publike "Prishtina Parking"', se është një shqetësim i madh i qytetarëve. Mendoj se është e rrugës ne si këshilltarë të zgjedhur të qyteti ta trajtojmë këtë çështje në seancën e radhës.

**Fatos Dibra** dha sqarime, duke cekur se KPF-ja nuk mund të sjellë pika të reja në rendin e ditës, ka të drejtë me i shqyrtuar vendimet që përcillen në Kuvend komunal ose me e sugjeruar kryetarin e Komunës me shtuar pika të reja.

#### **Pika e parë**

**Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 tetor - 31 dhjetor 2021 (TM4).**

#### **Pika e dytë**

**Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2021.**

**Valbona Ahmeti - Makolli** dha sqarime për këto dy pika, duke thënë se materialet ua kemi dërguar prej këtu në KPF nga ju anëtarët e Komitetit, nëse keni ndonjë pyetje, sugjerim apo vërejtje që me përgatitur për mbledhje të Kuvendit. Unë e di që juve ju intereson më shumë me ditur mjetet e të hyrave vetanake të cilat kemi me i bartur në muajin mars, e kemi obligim, se është pjesë e mbetur, është shuma prej 34.750,233.15 €, si informatë 16 milionë e 700 mijë euro, janë projekte të cilat për shkak të mos zgjedhjes së bordit të OSHP-së, ne si Komunë i kemi të bllokuara. Kjo është vetëm një pjesë. Pa e marrë një miratim Ministria e Financave, ne e kemi problem me vazhduar më tutje. Ky është problemi kryesor, sepse kanë mbetur këto mjete për bartje. Problem është edhe pandemia, e cila ka penguar në realizimin e këtyre projekteve, mirëpo për bartje janë këto mjete 34.750,233.15 €.

**Leutrim Retkoceri** tha se lidhur me këto dy pika, TM 4 dhe Raporti financiar buxhetor për vitin 2021, unë kisha thënë se duhet përsëri të diskutohen si të ndara, për shkak se na krijon praktikën që do ta kemi në vazhdimësi ashtu siç e kërkon Ligji, ndërsa sa i përket Raportit për buxhetin

për vitin 2021, sa u përket këtyre 16 milionëve që u përmendën, a keni pasur ndonjë komunikim zyrtar me OSHP-në se kur do të zhblllokohen. Nëse jo, atëherë kur do të zhblllokohet ky organ, në mënyrë që të realizohen këto projekte.

**Valbona Ahmeti - Makolli** dha sqarime lidhur me këtë çështje.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Raporti financiar buxhetor i Komunës për periudhën 1 tetor - 31 dhjetor 2021 (TM4), dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Raporti financiar buxhetor i Komunës për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2021, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

**Pika e tretë**

**Propozimvendimi për miratimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022.**

**Kryesuesi** tha se kanë mbajtur takim me grupin punues dhe për secilin muaj kemi bërë një draft të këtij Plani. Nëse keni sugjerime, ndryshime, mund t'i inkorporojmë në seancë të Kuvendit.

**Gëzim Sveçla** tha se në planin vjetor të punës së Kuvendit është paraparë "Propozimvendimi për caktimin e anëtarëve në komisionet e aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale të Komunës së Prishtinës", e nuk është pikë e seancës së radhës. A është kjo njëfarë kundërshtimi me vetë Planin.

**Nora Kelmendi** theksoi se edhe "Propozimet për këmbimin e pronave komunale me pronësi të personave fizikë", është e paraparë për muajin shkurt dhe nuk e kemi, por mos është e parapamë edhe ndonjë mbledhje në fund të muajit shkurt?

**Osman Bllaca** dha sqarime, duke thënë se është e mundur me u mbajtur edhe një mbledhje, por kjo është mbajtur para datës 11, me qëllim që anëtarët e Kuvendit me marrë pagën për këtë muaj, se ka edhe pika të tjera të gatshme për mbledhje.

**Gëzim Sveçla** tha se përmes përfaqësuesve tanë e kemi bërë një propozim, por me sa e pash, nuk ka hyrë në Planin e punës. Propozimi ka qenë që Kryetari me na raportuar për 100 ditët e para të tij. Prapë do të kërkojmë në seancën e Kuvendit.

**Valbona Ahmeti - Makolli** tha se më 10 mars bëhen 100 ditët, ne jemi duke e përgatitur raportin.

**Osman Bllaca** propozoi që në muajin mars të jetë si pikë e rendit të ditës "Raporti i kryetarit për 100 ditët".

**Bahri Gashi** kërkoi sqarime, që u cek nga parafolësit, se mbahet mbledhja në fillim të muajit për shkak të pagesës.

**Fatos Dibra** dha sqarime, duke thënë se është për shkak të realizimit të pagesës, sepse pagesat shkojnë në Ministrinë e Financave deri më datën 10 dhe nëse mbahet mbledhja më datë 15 mbetet me u paguar në muajin tjetër.

**Bahri Gashi** tha se nuk po më duket logjike me qenë paga përcaktuese.

**Osman Bllaca** dha sqarime.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për miratimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

#### **Pika e katërt**

**Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.**

Kryesuesi dha sqarime se përbërja e KPF-së ka ndryshuar, për shkak se z. Donat Lushaku nga radhët e LDK-së, ka dhënë dorëheqje, pasi që është emëruar drejtor i Drejtorisë së Kadastrit, atëherë LDK-ja deri në mbledhjen e Kuvendit duhet të propozojë një emër tjetër.

**Jeta Rafuna** shtroi pyetje për Zyrën ligjore. Në mandatin e kaluar në KPF kemi rënë në lajthitje, që si komitetet çka duhet të votojmë? Ne si komitet, me sa e kam kuptuar unë, ne duhet t'i votojmë vetëm propozimet që vijnë për këmbimin e pronave dhe të tjerat shkojnë në seancë.

**Fatos Dibra** dha sqarime lidhur me votimin e pikave në KPF-së.

**Donjeta Dragusha** theksoi se nëse roli i KPF-së është më tepër rol i ekspertizës me mbështetur ekzekutivin dhe kryetarin, atëherë votimi ynë mund të jetë formal, por nuk obligon asgjë për seancë. Përdërisa nuk obligon asgjë, ne mund të rekomandojmë, por atëherë votimi ynë nuk ka ndonjë vlerë.

**Valbona Ahmeti - Makolli** tha se prej praktikës së mëhershme, edhe unë kam kërkuar sqarime prej Ministrisë së Financave, kur është shpallur Raporti TM1, TM2, TM3, pse votohet, sepse po bie në kundërshtim ma ata, realisht ishin dy çështje. D.m.th. unë raportoju një muaj pasi të bëhen raportet, është informata çka është bërë, kanë të drejt kritike, sugjerime, këshilla shumë është rregull, por kur po votohet një punë që është kryer para tre muajve, po e qet në lajthitje krejt Kuvendin.

**Fatos Dibra** dha sqarime sipas Udhëzimit administrativ.

**Jeta Rafuna** theksoi se e bëra pyetjen për votimin në KPF, për shqyrtim është në rregull.

**Fatos Dibra** tha se realisht votimi në KPF është formal, sepse KPF-ja llogaritet si trup profesional që mund t'i dërgojë rekomandime profesionale kryetarit të Komunës, por jo votim që e heq një pikë të rendit të ditës ose e shtonë një pikë të rendit të ditës.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për formimin e Komitetit për Politikë e Financa dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

#### **Pika e pestë**

**Propozimvendimi për formimin e Komitetit për Komunitete.**

Kryesuesi tha se Komiti për Komunitete duhet t'i ketë 9 anëtarë, 7 janë dhe 2 duhet të propozohen në Kuvend.

**Betim Abullahu** tha se si Zyrë komunale për komunitete, në bashkëpunim me të gjitha komunitetet që jetojnë në komunën e Prishtinës, kemi punuar një muaj dhe në fund i kemi marrë propozimet e tyre për anëtarët që do të përfaqësojnë komunitetet e tyre në Komitetin për Komunitete. Në Prishtinë jetojnë 6 komunitete, i kemi emrat e 6 anëtarëve të komuniteteve dhe

2 duhet të propozohen në Kuvend. Ne i kemi edhe petitionet dhe deklaratat që ata i kanë propozuar. Kishte qenë mirë që prej Kuvendit të propozohen dy femra, për arsye se nëse nuk e arrin kuotën gjinore mundet me na kthyer MAPL-ja për ndryshim.

**Leutrim Retkoceri** pyeti se sa është kuota gjinore.

**Betim Abdullahu** theksoi se minimumi është 30%.

**Fatos Dibra** tha se çdo herë Ministria kërkon me qenë 50% me 50%, e njëjta është për KPF, sepse është komitetet i përhershëm.

**Leutrim Retkoceri** tha se në Kuvend është e domosdoshme që të dy propozimet të jenë për femra, për të mos na e kthyer Vendimin MAPL-ja, sepse kërkon me qenë kuota gjinore 50 % me 50% dhe për të qenë ky vendim i plotë duhet të propozohen dy femra.

**Gëzim Sveçla** kërkoi sqarime nga Zyra e komuniteteve se cilat janë kriteret që këta persona janë zgjedhur ose cili është kriteri që të tjerët po refuzohen. Sa kam marrë informacione, shumica janë që kanë qenë edhe në mandatin e kaluar. Atëherë pse duhet të njëjtit me qenë prapë, ne kemi ankesa prej qytetarëve, kemi prej dy komuniteteve, përfaqësuesja e komunitetit boshnjak, Mirsada Behluli, tash e sa mandate është, dhe pse nuk është pranuar Edina Qollakoviç.

**Betim Abdullahu** dha sqarime.

**Gëzim Sveçla** pyeti se cila është procedura, a keni procesverbale të atyre që kanë mbajtur mbledhje ose zgjedhje? Kishte qenë mirë me na e dhënë biografinë e këtyre personave e mos ta ngremë dorën për dikë që nuk e dimë se kush është.

**Betim Abdullahu** u përgjigj se kjo është procedura jonë, ku ne si Zyrë i marrim vetëm konfirmimet finale prej tyre, deklaratat dhe nënshkrimet.

**Leutrim Retkoceri** u shpreh, pasi po dëshiron Gëzim me qenë adresimi i tillë, forma si po zgjidhen anëtarët e komuniteteve, për mua zgjedh anëtar të këtij komiteti, ndoshta kjo është e rrugës me u ditur forma. Po ashtu, pyeti se a ka pasur njoftim publik që ata me u mbledhur.

**Betim Abdullahu** tha jo, nuk ka pasur njoftim publik në ueb -faqe.

**Gëzim Sveçla** sugjeroi që me i propozuar kryetarit, që kjo pikë e rendit të ditës me u shtyrë derisa të marrim informacione të mjaftueshme për procedurat dhe personat të cilët kandidohen për komitet.

**Mirsad Vitia** theksoi se procedura duhet me qenë e rregullt, nuk mundemi me u thirrur vetëm me një arsye se ka pasur pandemi.

**Leutrim Retkoceri** tha se në situata të tilla, ashtu siç e parasheh Rregullorja edhe thirrjet, nëse ka ankesa, këtë çështje më së miri mund ta sfidojë komuniteti nëse iu ka shkelur e drejta dikujt, sepse ne nuk kemi të drejtë, kompetencë me ua mohuar atyre për zgjedhje.

Ne mundemi me kërkuar një informatë shtesë lidhur me procedurën si është zhvilluar dhe a ka shkelje të tilla, nëse shkeljet janë evidente paraqet numër më të madh, s' do të thotë një njeri me qenë kundër një tjetri.

**Bahri Gashi** u shpreh i pajtimit me kolegun, duke thënë se nuk mundemi me ngritur dorën për dikën që nuk e dimë se kush është. Po ashtu, kam vërejtje se pse mos me qenë të gjithë, prej të gjitha grupeve ka nga një përfaqësues të të gjitha partive, nëse dëshirojmë me integruar duhet me u përfshirë të gjithë, por edhe ata duhet me u ditur kush janë, të paktën ta dimë kush janë, një biografi e shkurtër.

**Lulëzim Vrapca** dha sqarime lidhur me përzgjedhjen e anëtarëve të komitetit dhe thirrjen për përzgjedhje.

**Gëzim Sveçla** tha se neve po na intereson me ditur procedurën hap pas hapi të përzgjedhjes së përfaqësuesve të komuniteteve deri te momenti që na vjen neve kjo listë që na me votuar në Kuvend, kjo është puna e parë, dhe puna e dytë është biografia e personave të cilët propozohen të jenë përfaqësues të komiteteve.

**Betim Abdullahu** tha se mundet me ia kërkuar biografin secilit përfaqësues me petition etj., që për mbledhje të Kuvendit me i pasur ju, edhe për procedurat si shkojnë ua dërgoj.

**Gëzim Sveçla** pyeti se a janë pyetur përfaqësuesit e propozuar se a janë nën hetime.

**Fatos Dibra** dha sqarime.

**Leutrim Retkoceri** u shpreh se diçka çka është me rëndësi në Komitet për Komunitete, është që të jenë në rregull me Ligjin, mos të jenë p.sh. recidivistë të veprave penale, kjo është shumë me rëndësi, e sa i përket biografive, as drejtorët e mandateve të kaluara e as tani këta që po vijnë në Kuvend, nuk e kanë pasur obligim me na sjell biografinë, është mirë ne me ditur, por obligim nuk e kanë.

**Gëzim Sveçla** tha se Komuna e Prishtinës duhet me iu drejtuar MAPL-së, këtë punë duhet me pruar institucioni, në këtë rast Zyra për komunitete përmes organeve tjera të larta të Komunës. Ne si institucion t'i drejtohem MAPL -së me një udhëzim tjetër me na sjellë se kështu nuk është në rregull.

**Bahri Gashi** tha se u përmend diskriminimi prej kolegut, por unë nuk po shoh diskriminim, përkundrazi po shoh njëfarë avancimi që ne po dëshirojmë me punuar dhe me ndihmuar pak. Më shumë se herët e kaluara dhe nuk po më duket ideja që të ta ngremë dorën për disa njerëz që nuk dimë asgjë dhe çka kanë punuar deri sot. Jam i pajtimit me ditur se kush janë ata njerëz dhe çka kanë punuar deri tani, jam i interesuar me iu ndihmuar atyre njerëzve në atë komision nëse më lejohet.

**Fatos Dibra** tha se nëse diskutohet për një pikë të rendit të ditës dhe mbërrihet me u bërë një rekomandim, rekomandimet votohen se a procedohen më tutje apo jo, qitet në votim nëse ka rekomandim.

**Gëzim Sveçla** doli me këtë rekomandim: "Informatë mbi procedurën e përzgjedhjes së anëtarëve të Komitetit për Komunitete dhe biografit e tyre".

**Kryesuesi** e qiti në votim propozimin e Gëzim Sveçlës.

**Kryesuesi** konstatoi se u votua me 6 vota për, 2 kundër dhe asnjë abstenim.

**Nora Kelmendi** pyeti se a duhet votuar edhe rekomandimin për t'u futur si pikë e rendit të ditës edhe "Diskutim mbi gjendjen në ndërmarrjen publike "Prishtina Parking"".

**Fatos Dibra** tha se kryetari e merr informatën prej kryesuesit, nëse kryetari e ndanë rendin e ditës e dërgon prapë, nëse jo, ju e keni të drejtën para miratimit të rendit të ditës me propozuar si pikë, e voton Kuvendi hynë si pikë, nuk e voton Kuvendi nuk hynë si pikë.

**Gëzim Sveçla** tha se tani si rekomandim e ka për detyrë kryesuesi me ia përcjellë kryetarit.

**Fatos Dibra** tha po, ia përcjell kryetarit që ka një rekomandim të tillë nëse doni me futë si pikë të rendit të ditës.

**Bahri Gashi** tha se çështjet që i diskutojmë këtu mendoj me mbërriri njëfarë pike si rekomandim dhe me u bërë një votim nëse është me u votuar, jo obligativ, të paktën të dimë se po bëjmë diçka që me lënë njëfarë gjurme që po bëjmë një debat.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për formimin e Komitetit për Komunitete dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

**Pika e gjashtë**

**Informatë për suksesin e nxënësve në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2021/2022.**

**Lulëzim Vrapca** dha informatë lidhur me suksesin e nxënësve në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2021/2022.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Informata për suksesin e nxënësve në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2021/2022 dhe dërgohet në Kuvend.

**Pika e shtatë**

**Propozimvendimi për shfuqizimin e Vendimit, 01 - 422/01-0217897/20, të dt.26.11.2020, për subvencionimin e qytetarëve të komunës së Prishtinës të infektuar me COVID-19.**

**Valbona Ahmeti - Makolli** dha sqarime, duke thënë se në vitin 2020 është përkrahur nga asamblistët propozimi i ish-kryetarit për subvencionimin e qytetarëve të Prishtinës, të infektuar nga COVID 19, me një vlerë simbolike 50 €, ndërsa të moshuarit mbi 65 vjeç nga 100 €, dhe anëtarët e familjes si mbështetje për varrime.

Tani, pas marrjes së mandatit nga kryetari i ri, kam kërkuar me parë se ku është gjendja, sepse çdo vendim i ish-kryetarëve që kanë kaluar deri në shfuqizimin e tyre, sipas Zyrës ligjore janë në fuqi.

Mendoj se këtë vendim duhet shfuqizuar, për shkak të mos mundësisë së matjes dhe mungesës së mjeteve financiare në kategorinë e subvencioneve.

**Nora Kelmendi** tha se e përkrah drejtoreshën, por matja mundet me u bërë në IKSHPK, i ka të gjitha listat se IKSHPK-së, i nxjerr edhe listat e institucioneve private shëndetësore, por iu del shumë punë.

**Jeta Rafuna** tha llogaritet edhe me këto testet rapide që bëhen në QMF-të.

**Gëzim Sveçla** pyeti se a ka qenë si kriter me qenë vetëm testi i IKSHPK-së, apo edhe testet rapide.

**Valbona Ahmeti - Makolli** u përgjigj se vetëm raportet e IKSHPK-së janë marrë parasysh.

**Bahri Gashi** propozoi që të paktën të shikohen disa raste që janë më të ndjeshme, si raste sociale, pleq me iu ndihmuar.

**Leutrim Retkoceri** theksoi se kur ka ardhur ky propozim ne kemi qenë për rritjen e shumës nga 50 € në së paku 250 €, por ne si opozitë kemi mbërri me rritur vlerën për raste sociale dhe të moshuarit. Po ashtu, tha se ka pasur shumë ankesa prej qytetarëve për sistemin e aplikimit si sistem nuk ka qenë sistemi i krijuar mirë.

**Valbona Ahmeti - Makolli** dha sqarime, duke thënë se 800 mijë euro janë ndarë për Drejtorinë e Mirëqenies Sociale për t'u ndihmuar, sepse janë paraqitur kërkesa të mëdha, janë paraqitur raste të sëmundjeve, që janë dyfishuar, si ato malinje dhe kancer.

**Gëzim Sveçla** pyeti se nëse shfuqizohet Vendimi, çka do të ndodhë me ata qytetarë që janë të infektuar deri tash e nuk e kanë marrë shumën që u takon sipas këtij vendimi që ka qenë në fuqi.

**Valbona Ahmeti - Makolli** tha se në momentin që ne e kemi dorëzuar mandatin, nuk ka vazhduar më.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për shfuqizimin e Vendimit, 01 - 422/01-0217897/20, të dt.26.11.2020, për subvencionimin e qytetarëve të komunës së Prishtinës të infektuar me COVID-19 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

### **Të ndryshme**

**Leutrim Retkoceri** informoi se në mandatin e kaluar ka pasur një kërkesë për procedurën për inicim të ndryshimit - plotësimit të Rregullores për parkingje. Arsyeja është e thjeshtë, në atë rregullore ju mohohen disa të drejta qytetarëve dhe nuk ka pasur konsultime të mjaftueshme publike me qytetarë para se ajo të hyjë në fuqi. Besoj se një rishikim i kësaj rregulloreje do t'i kontribuonte mjaftueshëm situatës.

Sa i përket NP "Pastrimi" është ndërmarrje rajonale, të cilës iu kanë bllokuar xhirollogaritë dhe ka thënë se nga e mërkura nuk do ta vazhdojë aktivitetin për grumbullimin e mbeturinave, që do të ishte një veprim skandaloz i kësaj ndërmarrje sa i përket Prishtinës, se Prishtina është pagues më i madh. Jam i bindur që qytetarët e Prishtinës më së paku i kanë borxh kësaj ndërmarrje.

Unë kisha propozuar, do t'i rekomandoja edhe kryetarit, që në seancën e ardhshme të vijë të raportoj kryeshefi i kësaj ndërmarrje dhe të njoftojë se është e papranueshme prej të mërkurës mos të vazhdojë ndërmarrja aktivitetin. Nëse e zgjidhin problemin është në rregull, mos të vijnë fare nëse nuk e zgjidhin.

**Gëzim Sveçla** u shpreh se desha ta lidhë meqë është pak a shumë tema e njëjtë, që ne e propozuam me e futur si pikë e rendit të ditës për ndërmarrjen "Prishtina Parking" dhe duhet këtu me u shtjelluar dhe me ardhur në konkluzion që edhe ne të mendojmë se duhet me u ndryshuar kjo Rregullore, se po cenohen shumë gjëra, po cenohen bizneset, po cenohet liria e lëvizjes së qytetarëve. Njëherësh ai tha se ka ankesa nga qytetarët edhe për çmimin e parkingjeve. Në rast se na përkrahin edhe grupet tjera, mundemi sa më shpejt me filluar inicimin e ndryshimit të Rregullores.

Sa i përket NP "Pastrimi", sa e pash unë, Komuna e Prishtinës e ka marrë mbi vete një borxh që ka me paguar e i cili nuk është paguar.

**Valbona Ahmeti - Makolli** dha sqarime lidhur me çështjen e borxhit të NP "Pastrimi".

**Gëzim Sveçla** tha se nëse është bërë pagesa, kjo punë do të kryhet brenda ditës.



**Bahri Gashi** theksoi se duhet të shikohet që të bëhet zgjidhje për invalidët, sepse nuk janë liruar nga pagesa dhe nuk kanë vend parking.

**Leutrim Retkoceri** shprehu mendimin se ka nevojë me dërguar Rregulloren në plotësim-ndryshim. Rregullorja e punës së Kuvendit komunal ka hapësirë dhe mundësi me u ndryshuar dhe me iu përshtatur kohës dhe rrethanave të reja që i kemi. Kemi shumë kërkesa, në vazhdimësi kanë ardhur, por shkaku i kësaj Rregulloreje nuk kanë kaluar, andaj mendoj se është e nevojshme Rregullorja me e rritur funksionalizimin e punës së Kuvendit komunal të Prishtinës.

*Mbledhja përfundoi në orën 11:40.*

**Procesmbajtësja  
Shyhrete Islami**

**Kryesuesi i Komitetit  
Fehmi Kupina**

